

VENDIM
Nr. 104, datë 20.2.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 405, DATË 8.1.1996 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR
DHE RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 124 e 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 74 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “...i Republikës së Shqipërisë...” shifra “...prej 7350 km...”, hiqet.
 2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:
 - “2. Rrugët rurale të kategorizohen në rrugë rurale komunale dhe rrugë rurale rajonale.
 - a) Rrugë rurale komunale janë ato që lidhin:
 - qendrat e komunave me fshatrat dhe qendrat e banuara apo rrugët lidhëse ndërmjet fshatrave që kanë nën juridiksion.
 - b) Rrugë rurale rajonale janë ato që lidhin:
 - qendrat e komunave me qendrat e rrethit ose rrjetin rrugor kombëtar;
 - rrugë ndërmjet dy a më shumë komunave;
 - rrugë të rëndësisë së veçantë, si rrugët që lidhin qendrat e komunës ose fshatrat me qendrat muzeale, arkeologjike apo zona të tjera turistike.”
 3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Inventari i rrugëve rurale t’i kalojë në administrim njësive përkatëse të pushtetit vendor, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.”
 4. Pas pikës 6 shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, këshillat e qarqeve dhe këshillat e komunave për zbatimin e këtij vendimi.”
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano